



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2987 Prot,

Lezhë, më 01.03 .2021

VENDIM

Nr. 38 Datë 24.02 .2021

“PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË
CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË ZVRPP”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 64, ligjin nr. 9232 datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, ligjin nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe ligjin nr. 9321 datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave shtetërore dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

V E N D O S I :

1. Të përfundohen procedurat e privatizimit të apartamenteve për lidhjen e kontratave të shitblerjes para noterit, për banesat të cilat kanë mbetur pa u regjistruar pranë ZVRPP-së, sipas listës më poshtë :

Gjin Ded Përllëshi, Banesa nr.7, Rruga Torovicë, shkalla 1, Kati 1, Torovicë, Lezhë.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës së privatizimit para noterit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

